

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 14 KORRIK 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Sot, falë kësaj analize të institucioneve të pavarura të lidhura me drejtësinë, na jepet mundësia të bëjmë disa konsiderata lidhur me një debat të munguar për një krizë shumë të rëndë në të cilën ndodhet vendi në raport me drejtësinë, një drejtësi, e cila, po ta kishim bërë këtë seancë pas një jave, do të kishte plot 6 vjet nga kur është miratuar në këtë sallë me 140 vota. Është miratuar me 140 vota, por me të tjera pritshmëri, me të tjera synime dhe opinionin publik priste dy përgjigje të mëdha. Vetëm dy: të merrte një përgjigje shumë të fortë korrupsioni në këtë vend, e në mënyrë të veçantë korrupsioni i lartë, dhe, së dyti, qytetarët të preknin me dorë një drejtësi, e cila të ishte më e shpejtë, e drejtë dhe profesionale, dhe njëkohësisht të ishte e pakorruptuar dhe jo më klienteliste. Çfarë ndodhi realisht? Cila është fytyra e vërtetë e drejtësisë sot, për të cilën ne nuk jemi lodhur asnjëherë duke i vënë në dukje problemet shumë kritike që e shoqëruan, për shkak të objektivit të vetëm, të kapjes së saj?

Të gjitha duartrokitjet dhe kori i madh i propagandës, por jo i fakteve, kanë treguar vetëm e vetëm babëzinë për ta kapur. Sot, asnjëri, pa përjashtim asnjëri nga agjitorët politikë dhe qeveritarë, nuk u thotë dot qytetarëve se cilën gjë po prekin sot më të mirë nga ajo që kishin dje? T'u thonë një element, një të vetëm, konkret, ta ndiejnë, ta prekin, ta dinë kur shkojnë te dera e gjykatës se çfarë i pret. Përkundrazi, kanë pritur gjëra shumë më të këqija, shumë më të zeza, shumë më të errëta. Çfarë ka ndodhur realisht me drejtësinë? Çfarë thotë Departamenti Amerikan i Shtetit? Ai vë në dukje: "Reformat e drejtësisë janë dëmtuar nga korrupsioni i përhapur", ndërsa një vlerësues, jo i opozitës, por pikërisht drejtori i Përgjithshëm i Zërit të Amerikës, Elez Biberaj thotë: "Vendi po përjeton praktikisht zhbërjen e sistemit të kontrollit e të balancave dhe gjyqësori duket i paralizuar".

Dhe vazhdon: “Rama është përpjekur të forcojë pushtetin e tij në maksimum, duke ngushtuar hapësirën publike, duke minuar institucionet e pavarura, duke mbushur gjyqësorin me besnikë, nën maskën e reformave, dhe duke marginalizuar opozitën”. Nuk janë konsideratat e opozitës, por të drejtorit të Përgjithshëm të Zërit të Amerikës. Sigurisht, nuk pres t’i vini nofka edhe atij. Cila ishte kolona themelore që na shtyu drejt reformës në drejtësi? Këtu diskutuan edhe ish-anëtarë të Komisionit për Reformën në Drejtësi, dhe sinqerisht besova që do të kishin ndonjë ndjenjë të lehtë turpi, por nuk e kishin. Çfarë qe reforma në drejtësi? U miratua pas një analize të sistemit, u hartua me ekspertë të pavarur, u kërkua të mos fuste duart politika e nuk u lejua Ministria e Drejtësisë së kohës të propozonte qoftë edhe një rresht të vetëm.

Cila është reforma në drejtësi pas rrëmbimit socialist të pushtetit në një dorë të vetme? Dhjetëra ligje të reformës u propozuan vetëm nga Ministria e Drejtësisë. Nuk u konsultuan gjëkund me Komisionin e Venecias, i cili ishte parakushti i padiskutueshëm për reformën në drejtësi. Ligje të tëra, të cilat u miratuan dhe nuk u zbatuan dot asnjëherë, u ndryshuan pa u zbatuar qoftë edhe një ditë të vetme. Shkojmë më tej. Maja e diamantit e të ashtuquajturës “reformë në drejtësi” ishte pa diskutim vetingu. U fol kaq gjatë, kaq gjerë, kaq thellë dhe u shpenzuan kaq fuqi për ta shitur vetingun si një mrekulli që do të ndodhte, pavarësisht nga rezervat e forta që Komisioni i Venecias kishte në atë kohë, pra u shit si mrekullia e sistemit, i cili do të kishte në themelin e tij një premisë kryesore: të ishte proces solid.

Të gjithë ata që kryenin vetingun, anëtarët e tij të ishin qelibar të pastër. Ndryshe, veting, pra pastërti figure, me njerëz të papastër, nuk mund të kishte. E dimë të gjithë se shumica e anëtarëve u zgjodhën sipas lidhjeve nepotike apo edhe anëtarë të caktuar që përbënin komisionet e larta të të gjithë sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP, shkojmë me radhë edhe tek të tjerat), edhe me kundërshtitë e hapura dhe me rezervat e mëdha për të kaluarën e tyre. Vazhdojmë te vetingu. Tri këmbë kishte vetingu: vlerësimin e integritetit të figurës, vlerësimin profesional dhe atë të pasurisë. Çfarë ndodhi realisht? Degradoi në një inspektorat të deklarimit të pasurisë, të rëndomtë dhe dy kriteret, ato të cilët u kishin dhembur shqiptarëve në shpirt, profesionalizmi, mungesa e korrupsionit, vendimet e padrejta, integriteti i figurës, përfshirjet e

tyre me lidhje të dyshimta, qenë vetëm kritere periferike; 90 e ca për qind të tyre u larguan pikërisht për kritere pasurie.

Vijmë te pastërtia e vetingut. Po kush i largoi? I larguan gjyqtarë të vetingut, të cilët janë në ndjekje sot në SPAK për probleme me pasurinë. E ç'integritet kanë vendimet e tyre? Zero. Pastërtia e vetingut duhej të ishte dhe të mbetej e padiskutueshme. Komprometimi i tij, puna me dy standarde, mbyllja e syve përpara problemeve të mëdha që kishin gjyqtarë të caktuar, të preferuar, të dashuruar të qeverisë, nuk kishin problem, fshiheshin, bënë sikur shikonin, ndërsa qimen e shikonin te gjyqtarë të tjerë, të cilët kishin pasur edhe merita në punën e tyre për goditjen e krimit dhe të korrupsionit, të cilët u larguan nga vetingu. Kontrasti që shqiptarët duhet ta dinë është: gjyqtarët e vetingut ndodhen në SPAK, ndërsa gjyqtarëve të larguar nga vetingu u është pushuar çështja nga SPAK-u. Kjo është e vërteta.

Dilni e më thoni të ndryshmen! Hajdeni, gënjeni, se po ju pres të gënjeni, se e shuat Shqipërinë me gënjeshtër, me demagogji e me propagandë! Vijmë më tutje. Çfarë ka ndodhur për qytetarin e thjeshtë? Qytetari i thjeshtë ka vetëm këto probleme të mëdha: i janë shtuar çështjet, i janë bërë me mijëra. Nga 180 ditë që kërkonte mesatarja për një dosje, ka shkuar në 700 ditë, 2 vjet e ca. Kjo është e vërteta e reformës. Janë larguar me dhjetëra, qindra gjyqtarë. Ka zero strategji se si mbushet ky sistem, se si funksionon me numër të plotë. Gjykatat funksionojnë në mënyrë qesharake dhe mbingarkesa ka sjellë ulje në cilësinë e gjykimit, në vend të rritjes së cilësisë që prisnim, dhe shtim të kohës për dhënien e vendimeve; asgjë të mirë për qytetarët! E fundit, por jo më e pakta, është farsa me Hartën e re Gjyqësore.

Nuk e kuptoj dot se si mund të ketë një maxhorancë të idiotësuar nga mania për pushtet, saqë shqetësimin e Hartës Gjyqësore e ka Parlamenti European, që shprehet qartë në një nga pikat e rezolutës së tij të 19 majit, ndërsa të tërë "rilindësit" e telekomanduar nga Edi Rama nuk u shqetësuan. Epo kjo është një faqe e madhe e zezë që shqetësimi shkon deri në Bruksel, por nuk vjen në radhët e deputetëve "rilindës" të parlamentit shqiptar! Kjo është e vërteta e hidhur e reformës në drejtësi, se asaj të vërtete nuk ka vend për t'iu shmangur, por ka vend për të analizuar, për t'i shkuar deri në fund, për t'i dhënë përgjigje, në mënyrë që të mos thellohet

zhgënjimi nga besimi i madh që qytetarët kishin në atë zhgënjim të thellë në të cilin ai është transformuar. Faleminderit!